



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës merr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 24 VJETORIT TË BETEJËS SË KAÇANDOLLIT

Neni 1

Për shënimin e 24 vjetorit të Betejës së Kaçandollit, që do të organizohet më 15 shtator 2022, ngritët Këshilli Organizativ, në këtë përbërje:

1. **Marigona Lahu**, Nënkryetare e Komunës
2. **Edona Çitaku**, Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës
3. **Pajtim Balaj**, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
4. **Fadil Mulliqi**, Përfaqësues i Shoqatave të dala nga lufta
5. **Fatri Zhitia**, Zëdhënës i Komunës së Podujevës

Neni 2

Këshilli merret me organizimin dhe përgatitjet e aktiviteteve dhe programeve në nderim të shënimit të 24 vjetorit të Betejës së Kaçandollit, që do të mbahet më 15 shtator 2022.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Anëtarëve
QSHQ / Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0075031/22
Podujevë, datë, 01.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe nenit 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 12 të Ligjit 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese nga programet e veçanta të banimit, i formuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0086369/21 datë 30 shtator 2021, dhe atë;

2. **Florie Humolli**, zyrtare në kuadër të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë caktohet anëtare e Komisionit, në vend të znj.Mirsime Haxhiu e cila ka lidhë marrëdhënie pune në një Institucion tjetër jashtë Komunës së Podujevës.

Neni 2

Ky vendim është pjesë përbërje e Vendimit nr.prot.02-020/04-0086369/21 të datës 30.09.2021.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet;

Kryesueses së Komisionit

Anëtarëve të Komisionit dhe Drejtorive përkatëse (përmes kryesueses)

QSHQ / arkivës

Nr.prot. 02-020/04-0075729/22
Podujevë, datë; 02.09.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronjat b) f) dhe g) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjin nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/-247, Vendimin nr.3234/22 datë 03.06.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-MMPHI, Shkresës nr.4679 datë 18.08.2022 të MMPHI, si dhe në bazë të neneve 16 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr këtë,

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave në territorin e Komunës së Podujevës për të cilat ekziston e drejta banesore në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiwe komunale, në këtë përbërje;

1. **Skender Maloku**, zyrtar në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, kryesues
2. **Arsim Mehmeti**, zyrtar në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, anëtar
3. **Ejup Babatinca**, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar
4. **Faik Gashi**, zyrtar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtar
5. **Sabedin Namani**, zyrtar në Zyrën Ligjore, anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, kryen punët dhe detyrat, përkatësisht bënë shqyrtimin e kërkesave dhe shitjen e banesave në territorin e Komunave për të cilat ekziston e drejta banesore në përputhje me Ligjin nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/-247, në harmoni me Vendimin nr.3234/22 datë 03.06.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-MMPHI, si dhe Shkresës nr.4679 datë 18.08.2022 të MMPHI.

Neni 3

Për punën e kryer, Komisioni informon Kryetarin e Komunës në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe i njëjti i'u dërgohet anëtarëve të komisionit, MMPHI-DPHNB/Divizioni i Banimit për njoftim, si dhe një mbetje në QSHQ/Arkivën e Komunës.

Nr.prot.02-360/02-0076268/22
Podujevë, datë, 05.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, merr:

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Njëqindedyzetekatër (144) personave në gjendje të rëndë shëndetësore dhe sociale-ekonomike u jepet ndihmë financiare në shumë të përgjithshme 21,400.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listat e rekomanduara nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0076313/22
Podujevë, datë 06.09.2022



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas së projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), merr:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ANKESAVE NË PROJEKTIN ReLOaD2

Neni 1

Formohet Komisioni i ankesave në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), në këtë përbërje:

Xhevdie Beqiri, kryesuese
Janina Shala, anëtare

Florie Humolli, anëtare rezervë, në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi ka për detyrë që të merret me shqyrtimin e ankesave të projektit ReLOAD konform Marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës së Podujevës dhe Projektit ReLOaD 2.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/01-0076447/22
Podujevë, datë: 06.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QUEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E SHFAQJEVE TEATRORE

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet në fushën e aktiviteteve kulturore për shfaqje teatrore për skenën e fëmijëve në Teatrin e Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”, nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85142.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.


Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-04/01-0076863/22
Podujevë, datë: 06.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 24 paragrafi 1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.12-334/07-0071105/22 të datës 22.08.2022 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Ismet Shabani, nga fshati Livadicë, Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00€, me qëllim të kompensimit dhe rimëkëmbjes së ekonomisë së tij familjare si pasojë e dëmit nga ngordhja e lopës e cila i është ndarë subvencion në vitin 2022 nga Komuna e Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve, si dhe rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


U dërgohet:

Drejtorive përkatëse

QSHQ/Arkivit.

z.Ismet Shabani (njoftohet përmes DBPZHR-së)


Nr.prot 02-400/01-0077845/22
Podujevë, datë, 09.09.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.3 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.02-400/04-0072801/22 të datës 25.08.2022 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Idriz Mehmeti, nga Podujeva, trajner i Klubit të Futbollit të Veteranëve 'Llapi' në Podujevë, për pjesëmarrje në gara në kampionatin e Kosovës në futboll në kuadër të veteranëve të Kosovës, mbështetet me mjete financiare në shumë 700.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve, si dhe rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse

QSHQ/Arkivit.

z.Idriz Mehmeti (njoftohet përmes DKRS-së)

Nr.prot 02-400/01-0077844/22
Podujevë, datë, 09.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0076543/22 të datës 06.09.2022, për aplikim në projektin përkrahje me mekanizëm bujqësor, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Ymer Hoti, zyrtar Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - kryesues.

Behë Govori, zyrtar Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - anëtar.

Majlinda Gashi, zyrtare Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – anëtare.

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-00 81572 /22

Podujevë, datë 29.09.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenin 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Fadil Berisha, udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale në kuadër të Qendrës për Punë Sociale (QPS)-Podujevë, autorizohet të ushtrojë detyrat dhe punët si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të QPS-së.

Neni 2

Zyrtari sipas këtij Vendimi, autorizohet në kohëzgjatje deri në rekrutimin e Drejtorit të QPS-së sipas procedurave ligjore, dhe i njëjti gjatë kësaj periudhe përfiton pagën me kompensimin më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën autorizohet.

Neni 3

Vendimi ka efekt retroaktiv nga data 18.08.2022, përkatësisht nga dhënia e Autorizimit nr.prot. 02-020/05-0070213/22, sipas të cilit i përmenduri ka kryer punët dhe detyrat e Drejtorit të QPS-së.

Neni 4

Vendimi në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa pushon së vlejture Autorizimi nr.prot. 02-020/05-0070213/22 i datës 18.08.2022, i cili zëvendësohet me këtë Vendim.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Të autorizuarit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0081596/22
Podujevë, datë: 20.09.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Buñiqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 24 paragrafi 1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr. prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr. prot. 12-334/07-0078731/22 të datës 12.09.2022 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. prot. 02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z. Jon Jashari, fermer nga fshati Dobratin, Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 1000.00€, për sigurimin/blerjen e ushqimit për 300 krerë dele.

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të blegtorisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse

QSHQ/Arkivit.

z. Jon Jashari (njoftohet përmes DBPZHR-së)

Nr. prot. 02-020/04-0081531/22
Podujevë, datë, 20.09.2022



Kryetari i Komunës
Shefqet Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.7 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.02-615/03-0080367/22 të datës 16.09.2022 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Nazmi Rudari shkrimtar nga Podujeva, për botimin e librit me titull “Dramë”, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse

QSHQ/Arkivit.

z.Nazmi Rudari (njoftohet përmes DKRS-së)

Nr.prot 02-020/04-0081520/22
Podujevë, datë, 20.09.2022



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, nenit 10 të Rregullores komunale nr.prot.01-462/01-0062841/22 të datës 29.07.2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së palujtshme të komunës, neneve 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/02-0050862/18, nxjerr,

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim më pak se një (1) vit, si vijon;

Floriqe Humolli, zyrtare në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Kujtim Zhitia, zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjeje dhe Shpëtimit

Vedat Muqolli, zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Ragip Jaholli, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave

Flaka Ademi, zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kryesues i Komisionit do të jetë zyrtari nga Drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrje në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron në përputhje me rregullativën përkatëse ligjore në fuqi, me theks Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit, ndër të tjera duke bërë shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e kërkesave për marrjen e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim, përgatitjen e raportit përfundimtar, përfshirë edhe rekomandimin për palën e përzgjedhur/përfituese së bashku me Kontratën e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i pronës.

Neni 3

Mandati i komisionit është dy (2) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:

Drejtorive përkatëse dhe anëtarëve të komisionit

Zyrës së personelit

QSHQ /arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0082250 /22
Podujevë, datë, 22.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 11 të Rregullores komunale nr.prot.01-462/01-0062841/22 të datës 29.07.2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, neneve 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/02-0050862/18, nxjerr,

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1

Formohet komisionit për shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrihen kundër vendimit të vlerësimit të kërkesave nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim më pak se një (1) vit, si vijon;

Skender Maloku , zyrtar në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë,	kryesues
Valmire Rekalju , zyrtare në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjeje dhe Shpëtimit,	anëtare
Xheladin Çitaku , zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit,	anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron në përputhje me rregullativën përkatëse ligjore në fuqi, me theks Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit, ndër të tjera duke shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e parashtruara kundër procesit dhe vendosjes në vlerësimin e kërkesës/ave nga ana e komisionit vlerësues.

Neni 3

Mandati i komisionit është dy (2) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorive përkatëse dhe anëtarëve të komisionit
Zyrës së personelit
QSHQ /arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0082251/22
Podujevë, datë, 22. 09. 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, lëshon këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet Blerim Nishefci, zyrtar i lartë i personelit, i caktuar dhe aprovuar si zëvendësues sipas Kërkesës për pushim të datës 20.09.2022, që nga data 26.09.2022 të nënshkruaj dokumentacionin nga fushëveprimi i Zyrës së Personelit, derisa Fitim Bunjaku , Menaxher i Personelit të kthehet nga pushimi vjetor.

Nr.prot: 02-020/05-0082986/22
Podujevë, datë: 26.09.2022



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.prot.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.prot.01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024 nr.prot.01-400/03-0003128/22, datë 14.01.2022, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0002690/22, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, ndërlidhur me nenin 32 paragrafi 1 të rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, sipas Ftesës Publike të DBPZHR nr.prot.12-320/01-0076543/22, datë 06.09.2022, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE ME MEKANIZËM BUJQËSOR NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten 54 (pesëdhjetë e katër) fermer përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor"- vazhdim i implementimit të projektit, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas listës së përfituesve të përzgjedhur bashkëngjitur këtij Vendimi, dhe atë:

- *Shpëndrëse plehu* 27 përfitues
- *Makina mjelëse* 27 përfitues

Neni 2

Mbështetja e fermerëve sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të kulturave bujqësore në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-320/01-0082987/22
Podujevë, datë, 26.07.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtm Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë/ propozim nr.02-020/04-0081518/22 të datës 20.09.2022, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit sipas ftesës publike nr.09-615/02-00071631/22 të datës 23.08.2022, merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-KLUBEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS PËR SEZONIN VJESHTOR

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-Klubeve Sportive, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushën e aktiviteteve sportive publikuar më 23.08.2022, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- 1.Ejup Babatinca, kryesues, udhëheqës i sektorit të ekonomisë - Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - DPZHE.
- 2.Xhevrie Beqiri, anëtare, zyrtare për kthim të qëndrueshëm 1- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKK
- 3.Florie Humolli, anëtare, zyrtare ligjore 1, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ.
- 4.Viona Bunjaku, anëtare, shoqëria civile.
- 5.Gramos Latifi, anëtar, shoqëria civile.

z.Vedat Muçolli, zyrtar për sport caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot 02-020/04-0082991/22
Podujevë, datë, 26.09.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-i autorizuar në punët dhe detyrat nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit nr. prot. 02-020/05-0083092/22, datë 27.09.2022, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Ejup Babatinca, udhëheqës i sektorit për zhvillim ekonomik në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të Sektorit për inspektime në Drejtorinë e Inspeksionit-DI.

Neni 2

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe vlen deri në emërimin e udhëheqësit të sektorit sipas procedurave ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 4

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së udhëheqësit të Sektorit për inspektime në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit.

Nënshkrimi i të autorizuarit

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari

z. Bahri Selimi, i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorit të DI

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-020/02-0083119/22
Podujevë, 27.09.2022



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-020/02-0011343/22, datë 16.02.2022, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOSSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË EKONOMIKE - SHMLE "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË

Neni 1

z. **Xhevdet Rrahimi**, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit 2022/02/020/02-0011343/22, me kualifikim jurist i diplomuar-Fakulteti juridik,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Zëvendës Drejtorit të SHMLE "Isa Boletini", në Podujevë.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit

Nr.prot. 02-020/02-0083840/22
Podujevë, datë 29.03.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-020/02-0011343/22 , datë 16 02. 2022, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË EKONOMIKE - SHMLE "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË

Neni 1

z.Muhamed Sejdiu, nga fshati Obrancë, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit 1703/2022, me kualifikim MSC i Shkencave Ekonomike – Kolegji i Menaxhmentit international,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHMLE "Isa Boletini", në Podujevë.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtoria e Arsimit
Të emëruarit
Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0083838/22
Podujevë, datë: 24.07.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) në kuadër të Ministrisë së Financave Punës dhe Transferove (MFPT) nr. prot. 486 datë 14.09.2022 dhe Komunës së Podujevës nr. 02-111/02-007768/22, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Komisioni për përzgjedhjen e punëkërkesve për angazhim në punë praktike në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Makfirete Zeka, kryesuese
Xhevrie Beqiri, anëtare
Mimoza Restelica, anëtare

Neni 2

Komisioni bën përzgjedhjen e punëkërkesve të regjistruar si të papunë në Zyrën e Punësimit nga lista e gjerë e përgatitur dhe dërguar nga Zyra e cekur, si dhe kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:
Anëtarëve të komisionit
Zyra e Punësimit-Podujevë
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/04-008162/22
Podujevë, datë: 24. 09. 2022

